

**SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT TË PROVIMIT TË MATURËS NGA  
GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA, GUSHT 2017**

1. Nxënësi/nxënësja\* merr **1 pikë** nëse shkruan: *Ajo lexonte vargjet e Pushkinit dhe Tjutçevit dhe nuk i kuptonte vargjet moderne “të shkëputura, të ashpra, të copëtuara” të poetit Majakovski./ Majakovski ishte “i egër, i zemëruar, i pa rezervë” dhe e frikësoi Tatjana Jekovlevën pasionin e tij të shfrenuar. (dhe përgjigje tjera të sakta)*

Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil nxënësi merr **2 pikë**

2. Nxënësi merr **2 pikë** nëse shkruan: *E ka shkruar këngën “ Letra Tatjanës Jakovleva” dhe sipas porosisë së tij Tatjana Jakovlevës disa herë në javë i arrinin lule me porosinë “Nga Majakovski”. (dhe përgjigje tjera të sakta)*

Nëse nxënësi shkruan vetëm një nga mënyrat me të cilën ka shfaqur dashuri, ose shkruan përgjigjen e plotë por pa stil, merr **1 pikë**.

3. Është rrethuar numri 3. Për shkak se të gjithë honorarin nga shfaqja në Paris e shpenzoi në lule për Tatjanën - **1 pikë**

4. Nxënësi merr **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë (për përgjigje të rrethuar dhe të arsyetuar saktë):

KONSTATIMI	PO	JO	ARSYETIMI I PËRGJIGJES
Për shkak të dashurisë së pakthyer Majakovski i dëshpëruar u kthye në Moskë.	<input checked="" type="radio"/> PO	<input type="radio"/> JO	<i>Për Tatjanën Majakovski nuk kishte asnjë domethënie përkundër dashurisë së tij, famës, besnikërisë... (dhe përgjigje tjera të sakta)</i>
Dashuria e Majakovskit e shpëtoi Tatjanën në kohën e Luftës së Dytë Botërore.	<input checked="" type="radio"/> PO	<input type="radio"/> JO	<i>Lulet që i merrte edhe pas vdekjes së tij i shite në bulevard dhe arriti të mbijetojë (dhe përgjigje tjera të sakta)</i>
Miku i Majakovskit, Arkadij Rivlin, e vizitoi Tatjana Jakovlevën.	<input type="radio"/> PO	<input checked="" type="radio"/> JO	<i>Arkadij Rivlin nuk ishte mik i Majakovskit... (dhe përgjigje tjera të sakta)</i>

Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar dhe arsyetuar saktë dy përgjigje.

Nxënësi merr **0 pikë** nëse ka rrethuar dhe arsyetuar saktë një përgjigje.

---

\*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

5. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *E dinte se furnizuesi do ta sillte buqetën me lule me porosinë “Nga Majakovski” ashtu që Arkadij Rivlin vetë u bind në vërtetësinë e tregimit për Majakovskin dhe lulet. (dhe përgjigje tjera të sakta)*
6. Është rrethuar numri 1 – interpretimi i pikturës - **1 pikë**
7. Është rrethuar numri 3 – shkencor - popullor - **1 pikë**
8. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *portret/portret i jashtëm*
9. Nxënësi merr **1 pikë** nëse përshkruan ose perifrizon fjalitë: Edhe pse me një format të vogël, piktura zbulon një lojë shumë të efektshme të dritës dhe elementëve të errët. Hedhja e ngjyrave është e ndryshueshme, e zbutur me kujdes me kalime të dukshme, krahas veprimeve spontane me penel, gërvishnje, njolla dhe me pika. *(dhe përgjigje tjera të sakta)*
10. Nxënësi merr **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:
- tek - lidhëz
- pas - ndajfolje
- kërcënuese - mbiemër
- nëpër - parafjalë
- Nxënësi merr **1 pikë** për dy ose tri përgjigje të sakta.
- Nxënësi merr **0 pikë** për një përgjigje të saktë.
11. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Do të pëlqehesh.*
12. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Lidhëz shtuese dhe krijon idenë e përmbylljes së diçkaje; tregon përmbylljen e mendimit.*
13. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Motivi i dashurisë.*
14. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Fjala qelq krijon efektin e menjëhershëm, krijon lidhjen me ndjenjën e mallit po aq të brishtë dhe të pastër sa qelqi dhe shiu. (dhe përgjigje tjera të sakta)*
15. Është rrethuar numri 2 – Për ty befas ndjeva mall - **1 pikë**

16. Është rrethuar numri 3 – simbolit - **1 pikë**.
17. A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *“Hasta la vista”*
- B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Petro Marko*
18. A) Është rrethuar numri 3 – Spanjës në vitin 1936 - **1 pikë**
- B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Jeta dhe veprimet e vullnetarëve shqiptar dhe solidariteti.*
- Nxënësi merr **2 pikë** nëse jep një përgjigje më të plotë dhe me stil: *Jeta dhe veprimet e vullnetarëve shqiptar dhe solidariteti. Përveç këtyre trajtohet edhe motivi i dashurisë. Paraqiten tablo lufte, episode aksionesh, luftimesh frontale, bombardime, vrasje, plagosje etj.*
19. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Që ta urrenin regjimin e shtypjes.*
20. Është rrethuar numri 2 – Gorin - **1 pikë**
21. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Romanit*
22. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Mbaron (diçka), merr fund, mbyllet.*
23. Nxënësi merr **2 pikë** nëse shkruan saktë të gjithë numrat e dhënë:
- 17 - shtatëmbëdhjetë
- 21 - njëzet e një
- 600 - gjashtëqind
- 1911 - njëmijë e nëntëqind e njëmbëdhjetë
- Nxënësi merr **1 pikë** për dy ose tri përgjigje të sakta.
- Nxënësi merr **0 pikë** për një ose asnjë përgjigje të saktë.
24. A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka nënvizuar fjalën: zhbëj
- B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Shumë i ngadalshëm*

25. A) Nxënësi merr **1 pikë** për presjet e shkruara saktë:  
Ai foli me ta edhe për kohën e mirë, edhe për mbjelljet e kryera, edhe për dëborën e parë, edhe për duhanin.
- B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shpjeguar përdorimin e presjes në shembullin e dhënë: *Ndahen me presje gjymtyrët homogjene që bashkohen me lidhëza të përsëritura, edhe..., edhe...*
26. Gjithsej **3 pikë**: Nxënësi merr nga 1 pikë për çdo përgjigje të saktë (titullin e veprës dhe autorin e saj):
- “Gjahu i malësorëve”, *Konstandin Kristoforilli*
- ”Vaje”, *Andon Zako Çajupi*
- “Kush i pari bani”, *Esad Mekuli*
27. Gjithsej **2 pikë** për të katër përgjigjet e sakta:
- Arnaut Osmani dhe Hyso Radoica* - epikë/ baladë
- Antigona* - dramë/poezi dramatike
- liada* - epikë/ poezi epike
- Sheshi i unazës* - gjinia tregimtare/roman
- Nxënësi merr **1 pikë** për dy ose tri përgjigje të sakta.
- Nxënësi merr **0 pikë** për një ose asnjë përgjigje të saktë.
28. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka nënvizuar *Honore dë Balzak*
- Vërejtje:** Nuk pranohet përgjigje e saktë nëse ka rrethuar edhe përgjigjen e saktë dhe të pasaktë.
29. Është rrethuar numri 2 – mistifikimi - **1 pikë**

### 30. Skema për vlerësimin e esesë: “HANKO HALLA”, ALI ASLLANI

<p><b>Kërkesa</b> <b>1.</b></p>	<p>Nxënësi shkruan se: - kjo është një poemë tregimtare <b>Gjithsej 1 pikë</b></p>
<p><b>Kërkesa</b> <b>2.</b></p>	<p>Nxënësi shkruan se: - poema përbëhet nga 4 pjesë që kanë gjithsej 25 këngë <b>1 pikë</b> - tema e poemës është kundërshtimi i përparimit dhe qytetërimit nga Hanko Halla <b>1 pikë</b> - subjekti i veprës është në formë të vetërrëfimit të Hallës e cila vetë tregon dhe vetë monologon <b>1 pikë</b> - personazhet e veprës janë Hanko Halla, nusja, i biri, prifti, mjeku, harbuti dhe lajmëruesi <b>1 pikë</b> <b>Gjithsej 4 pikë</b></p>
<p><b>Kërkesa</b> <b>3.</b></p>	<p>Nxënësi: - shkruan se Hanko Halla ndihet keq nga bota që e rrethon <b>1 pikë</b> - tregon se kontaktin e parë Hanko Halla e ka me lajmëruesin i cili kërkon mbesën për grua, kurse të dytin e ka me të renë e vet me të cilën bie në konflikt <b>1 pikë</b> - veçon ndonjë varg që i ilustron ndjenjat e Hanko Hallës dhe karakterit të saj në botën e re <b>1 pikë</b> - tregon se figura e Hanko Hallës na vjen si figurë e ngjizur me traditën popullore <b>1 pikë</b> - tregon se vargu është 12 rrokësh me rimë të puthitur <b>1 pikë</b> <b>Gjithsej 5 pikë</b></p>
<p><b>Kërkesa</b> <b>4.</b></p>	<p>Nxënësi: - shkruan se forma, struktura e vargut, rima dhe figurat themelore janë të mbështetura në ritmin popullor <b>1 pikë</b> - tregon se Halla e ka kaluar rininë e saj dhe për këtë arsye ajo flet dhe sillet nga pozicioni i humbësit e cila nuk dëshiron ta lëshoj “fronin” e saj, kurse nusja duke qenë e re do të jetojë rininë, me gjithçka që ajo i ofron <b>1 pikë</b> - jep ndonjë shembull të këtyre pakënaqësive dhe mospajtimit në mes të brezave <b>1 pikë</b> <b>Gjithsej 3 pikë</b></p>
<p><b>Kërkesa</b> <b>5.</b></p>	<p>Nxënësi tregon se: - Halla është një karakter simpatik dhe shumë i këndshëm njerëzor por i pandryshueshëm <b>1 pikë</b> - mësimi moral është që nëse brezi i vjetër e ka vështirë ta kuptojë brezin e ri, të rinjtë mund të bëjnë lehtësisht përpjekje për ta kuptuar brezin e vjetër. Dhe për të jetuar në kënaqësi e në respekt reciprok, si pjesëtarë të së njëjtës familje <b>1 pikë</b> <b>Gjithsej 2 pikë</b></p>

## Gjuha dhe forma e tekstit

Leksiku	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Struktura ndërtimore e tekstit
<p>originaliteti (interpretion me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, fjalitë me stil</p> <p><b>3 pikë</b></p> <p>originaliteti (interpretion me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë me gabime minimale</p> <p><b>2 pikë</b></p>	<p>respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), e kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve <b>për</b> dhe <b>mbi</b>, përemrit <b>i vet/ i tij</b>, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: <b>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</b> dhe i përemrave: <b>që, i cili, e cila, të cilët</b> etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali, renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p>respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave <b>r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë</b>, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të</p>	<p>lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve</p> <p><b>1 pikë</b></p>	<p>përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellimit ndan paragrafët)</p> <p><b>2 pikë</b></p>

	<p>fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores ë, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j)</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 4 pikë</b></p>		
<p>përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta, fjalitë pa stil</p> <p><b>1 pikë</b></p>	<p>respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve <b>për</b> dhe <b>mbi</b>, përemrit <b>i vet/ i tij</b>, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit <b>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</b> dhe i përemrave: <b>që, i cili, e cila, të cilët</b> etj.)</p> <p><b>1 pikë</b></p> <p>respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të pakta (p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores ë, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk</p>		<p>ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit</p> <p><b>1 pikë</b></p>

	shkruhet bashkëtingëllorja j) <b>1 pikë</b>  <b>Gjithsej 2 pikë</b>		
--	--	--	--

**Skema për vlerësimin e esesë: MIQËSIA NUK ZGJEDHET, AJO NDODH, KUSH E DI PËRSE, SI DASHURI.**

<b>Kërkesa 1.</b>	<p>Nxënësi përshkruan: - rëndësinë e miqësisë <b>1 pikë</b></p> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil 1 pikë</i></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>
<b>Kërkesa 2.</b>	<p>Nxënësi :</p> <p>- numëron disa virtyte të cilat janë të rëndësishme për një miqësi të sinqertë <b>1 pikë</b> - përshkruan virtytin të cilin veçanërisht e veçon dhe e vlerëson te miku <b>1 pikë</b></p> <p><i>Për një përshkrim më të plotë 1 pikë</i></p> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil 1 pikë</i></p> <p><b>Gjithsej 4 pikë</b></p>
<b>Kërkesa 3.</b>	<p>Nxënësi përshkruan: - portretin e jashtëm të shokut/shoqes më të mirë <b>1 pikë</b> - portretin e brendshëm të shokut/shoqes më të mirë <b>1 pikë</b></p> <p><i>Për përshkrimin e brendshëm të plotë dhe me stil 1 pikë</i></p> <p>Nxënësi shpjegon se cilit portret i jep përparësi <b>1 pikë</b></p> <p><i>Për një shpjegim të plotë dhe të shkruar me stil 1 pikë</i></p> <p><b>Gjithsej 5 pikë</b></p>
<b>Kërkesa 4.</b>	<p>Nxënësi: - jep qëndrimin e vet për rëndësinë e miqësisë së sinqertë <b>1 pikë</b></p> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil 1 pikë</i></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>
<b>Kërkesa</b>	Nxënësi sqaron:



<b>5.</b>	<p>- titullin e esesë <b>1 pikë</b></p> <p><i>Për një përgjigje të plotë dhe të shkruar me stil <b>1 pikë</b></i></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>
-----------	---

### Gjuha dhe forma e tekstit

Leksiku	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Struktura ndërtimore e tekstit
<p>originaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, fjalitë me stil</p> <p><b>3 pikë</b></p> <p>originaliteti (interpretim me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë me gabime minimale</p>	<p>respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), e kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve <b>për</b> dhe <b>mbi</b>, përemrit <b>i vet/ i tij</b>, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: <b>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</b> dhe i përemrave: <b>që, i cili, e cila, të cilët</b> etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali, renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p>respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i</p>	<p>lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve</p> <p><b>1 pikë</b></p>	<p>përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellitimit ndan paragrafët)</p> <p><b>2 pikë</b></p>

<p><b>2 pikë</b></p>	<p>shkronjave <b>r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë</b>, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores <b>ë</b>, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja <b>j</b>)</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 4 pikë</b></p>		
<p>përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta, fjalitë pa stil</p> <p><b>1 pikë</b></p>	<p>respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve <b>për</b> dhe <b>mbi</b>, përemrit <b>i vet/ i tij</b>, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit <b>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</b> dhe i përemrave: <b>që, i cili, e cila, të cilët</b> etj.)</p> <p><b>1 pikë</b></p> <p>respektimi i normës drejtshkimore me gabime të pakta ( p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit,</p>		<p>ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit</p> <p><b>1 pikë</b></p>

	<p>mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores ë, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j)</p> <p><b>1 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>		
--	---	--	--